



Me rastin e Asamblesë së Shtatë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 23 shtator 2009

Asambleja e përbërë nga Gjyqtarët: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Nën-Kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gjyqtarët e EULEX-it: Angela Kaptein; Antoinette Lepeltier-Durel; Arkadiusz Sedek; Christine Lindemann-Proetel; Dragomir Yordanov; Eija-Liisa Helin; Ferdinando Buatier de Mongeot; Francesco Florit; Gerrit-Marc Sprenger; Gianfranco Gallo; Hajnalka Karpati; Harri Katara; Klaus Jung; Piero Leanza; Richard Winkelhofer; Torsten Koschinka; Vitor Pardal; Vladimir Kanev.

Miraton VENDIM

Me 18 vota për, dhe 2 abstenime, për aprovimin e kësaj këshille për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatat e Kosovës mbi trajtimin e ekzekutimit të lëndëve pas paraqitjes së ankesës.

K Ë S H I L L Ë

Për:

- Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Kryetarët e Gjykatave të Qarkut dhe Komunale të Kosovës

Prej: Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Komponenti i Drejtësisë i EULEX-it

Lënda: Këshillë për Gjykatat e Kosovës mbi trajtimin e përmbarrimit të lëndëve pas paraqitjes së ankesës

1. Përmbledhje Ekzekutive

Siç parashihet me nenin 3 të Veprimit të përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian të

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenyja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



Sundimit të Ligjit të në Kosovë, kjo ka për detyrë të “(a) monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë institucionet kompetente të Kosovës në të gjitha fushat lidhur me sundimin e ligjit në tërësi (përfshirë shërbimin doganor), duke mbajtur disa përgjegjësi të caktuara ekzekutive”.

Neni 2.4 i Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008 (Ligji nr. 03/L-053) përcakton se: “përveç ushtrimit të funksioneve gjyqësore në përputhje me dispozitat e neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjyqtarët e EULEX-it do të monitorin, udhëzojnë dhe këshillojnë gjyqtarët kosovarë për sa i përket parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe në përputhje me modalitetet e përcaktuara me anë të këtij ligji EULEX-i KOSOVË”.

Në veçanti, këshillimi përbëhet nga qëndrimet zyrtare dhe formale të përbashkëta të gjyqtarëve të EULEX-it në Asamblesë e gjyqtarëve të EULEX-it dhe i drejtohen organeve vendore gjyqësore, legjislative apo organeve të qeverisë për të stimuluar veprimet e tyre në fushat kompetente përkatëse. Me fjalë të tjera, këshillimi ka për qëllim sigurimin e këshillave profesionale për organet kompetente (Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kryetarët e Gjykatave, Gjykatën Supreme, Parlamentin, Fakultetet e Drejtësisë) mbi çdo temë që ngrihet nga përvoja e monitorimit dhe udhëzimit. Këshillimi i siguron palës së interesuar Kosovare informata të hollësishme të domosdoshme për intervenim në ato fusha të sistemit të drejtësisë që kanë nevojë për implementimin e përmirësimeve të përgjithshme dhe strukturale në tërë sistemin e drejtësisë dhe që nuk mund të zbatohen me anë të aktivitetit monitorues të gjyqtarëve të EULEX-it.

Ky udhëzim për Kryetarët e gjykatave të Kosovës mbi trajtimin e ekzekutimit të lëndëve pas ankese paraqet rezultatin e aktiviteteve të monitorimit dhe të udhëzimit të Gjyqtarëve të EULEX-it, duke u këshilluar ngushtë me kolegët e tyre kosovarë. Këto aktivitete kanë vënë në pah se gjykatat e shkallës së parë në praktikë e ndalojnë procedurën kur një lëndë përmbartimore është ankimuar dhe nuk e vazhdojnë përmbartohet gjersa gjykata e apelit të ketë arritur një vendim. Praktikrat e tanishme nuk janë në përputhje me ligjin e Kosovës dhe me praktikrat më të mira evropiane. Këto gjetje dëshmojnë nevojën urgjente për ndryshimin e praktikës së tanishme në këto lëndë, që do të rriste efikasitetin e procedurës përmbartimore në Kosovë.

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjya e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu

2. Hyrje

Ekziston një problem serioz me lëndët e prapambetura përmbartimore në tërë Kosovën. Në përputhje me statistikën e raportit të KGjK-së për 2008 (“Raporti për 2008 – Statistika mbi gjykatat e rregullta”), numri total i lëndëve



përbarimore civile 74.679 në Gjykatat Komunale nuk ishin përfunduar në fund të vitit 2008, që paraqet 41 për qind të numrit total të lëndëve të papërfunduara në Gjykatat Komunale të Kosovës.

Ekzekutimi me kohë i të drejtës përbarimore në emër të kreditorëve që e kanë këtë të drejtë formon pjesë të rëndësishme të sistemit gjyqësor të bazuar në Sundimin e Ligjit. Pa ekzekutim, procedurat gjyqësore paraprijëse nuk kanë kurrfarë rëndësie për kreditorin. Prandaj, hapi i fundit i procedurës duhet të jetë i efektshëm me qëllim që kreditori të marrë rezultatin që i takon të procedurave dhe që procedurat gjyqësore të arrijnë formën e prerë.

Ekzekutimi i shpejtë i titujve ekzekutues është thelbësor për respektin e shoqërisë për gjykatat dhe sistemin gjyqësor. Nëse palët nuk kanë garanci që vendimet do të kryhen me kohë, ata e humbin besimin në sistem dhe mund të kërkojnë mjete të tjera për të siguruar pagesat. Veç kësaj, përbarimi është i rëndësishëm pasi që kujdeset sa i përket obligimeve monetare. Së fundi, për palët e përfshira padyshim është e rëndësishme që të jenë në gjendje të shkojnë përpara prej kontestit, i cili mund të kryhet vetëm pasi të vendoset përfundimisht për të.

3. Situata e tanishme

Gjatë kryerjes së funksioneve të MUK-ut dhe takimit me gjyqtarët e Gjykatave të Kosovës, është qartësuar praktika standarde e Gjykatave kur të ankimohet lënda përbarimore. Kur parashtrohet ankesa kundër lëndës përbarimore, lënda përbarimore në tërësi i dërgohet gjykatës së apelit në mënyrë që të vendoset për ankesën. Asnjë kopje e lëndës nuk mbahet në gjykatën e shkallës së parë dhe prandaj procedura është ndalur duke pritur vendimin në lidhje me ankesën. Në kundërshtim të kësaj praktike, Ligji i procedurës përbarimore (Ligji Nr. 03/L-008) neni 12.6 thotë se ankesa nuk e ndalon procedurën përbarimore.

Zakonisht, ankesa kundër lëndës përbarimore nuk e ndalon ekzekutimin në praktikën e Shteteve Evropiane. Gjykata e shkallës së parë në rast të ankesës së lëndës do të dërgojë shkresat origjinale të lëndës te gjykata e ankesave dhe mban një kopje të saj për të qenë në gjendje të vazhdojë përbarimin apo të mbajë origjinalin e shkresave të lëndës dhe të dërgojë kopjen në gjykatën e ankesave. Në këtë mënyrë përbarimi mund të vazhdojë përkundër ankesës.

Si pasojë, praktika e tanishme e gjykatës së shkallës së parë në Kosovë nuk është në pajtim as me ligjin e Kosovës e as me praktikën më të mirë evropiane. Praktika e tanishme në Gjykatat e Kosovës është padyshim faktor që ngadalëson procedurat përbarimore dhe me këtë krijon ngarkesa në lidhje me këto lëndë. Nëse gjyqtarët në shkallën e parë do të mund të vazhdonin më mirë me përbarimin përkundër ankesës atëherë procesi i përbarimit do bëhet më efikas. Me thjeshtë kopjimin e shkresave të lëndës përbarimore të ankimuar para dërgimit të shkresave origjinale të lëndës te gjykata e ankesave, gjyqtari i shkallës së parë do të jetë në gjendje të vazhdojë përbarimin

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenyja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu



përkundër ankesës, kështu duke proceduar në pajtim me ligjin dhe praktikat më të mira evropiane.

4. Rekomandim

Në frymën e konkluzioneve të mësipërme, rekomandimi i tanishëm i është prezantuar Gjykatave të Kosovës:

Kur të parashtrahet ankesë kundër lëndës përmbartimore, një kopje e shkresave të lëndës duhet të mbahet në gjykatën e shkallës së parë dhe procedura përmbartimore duhet të vazhdoj edhe pse ankesa është në pritje në gjykatën e ankesave.

5. Konkluzion

Përmirësimi i ngarkesës me lëndët përmbartimore është detyrë e rëndësishme për Gjykatat e Kosovës. Një hap i rëndësishëm do të ishte ndjekja e këshillës së dhënë në këtë tekst, e cila është e bazuar në ligjin e Kosovës dhe në praktikat më të mira evropiane. Kjo do të mund ti ndihmonte gjykatat që më mirë ti qasen ngarkesës së tanishme dhe palët e ndikuara do të sigurohen me përmbartime më efektive të vendimeve.

Për arsyet e lartpërmendura, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it

KËSHILLON

Kryetarët e Gjykatave të Kosovës të pranojnë rregullat e zakonshme në gjykatat e tyre përkatëse që do të siguroj që kopja e shkresave të lëndës të mbahet në gjykatat e tyre kur lënda përmbartimore është ankimuar dhe të tërheqin vëmendjen gjyqtarëve të gjykatave të tyre në dispozitat e nenit 12.6 të Ligjit mbi Procedurën Përmbartimore (Ligji Nr. 03/L-008) me qëllim që ata mos ta ndalin procedurën përmbartimore për shkak të ankesës.

Rekomandimi i tanishëm i është prezantuar KGJK-së që ti pajis Gjykatat me përkrahje të nevojshme logjistike.

Kryesia e Asamblesë së
Gjyqtarëve të EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Rruga Luan Haradinaj
Avenjja e Policisë

Fahu Postar: 268, 10000
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381(0)38 222 0104111
www.eulex-kosovo.eu

Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it